

## PSIKOLOGJIA GJUHËSORE TE FOLËSIT NJËGJUHËSH, DYGJUHËSH DHE SHUMËGJUHËSH

### AJTENE QAMILI

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqiptare, Universiteti “Shën Cirili e Metodi”  
Bul. Kërste Misirkov, p. n., 1000, Shkup, MAQEDONI  
Emaili: teni79@yahoo.com

#### Përmbledhje

Gjuha shqipe, si gjuhë e lashtë në këto troje, ka zgjuar interes të veçantë te shumë gjuhëtarë dhe deri më sot është studiuar në shumë aspekte dhe në disa fusha më shumë e në disa më pak. Në aspekt psikolinguistik është studiuar fare pak, për të mos thënë, aspak, sepse kjo disiplinë është e re jo vetëm për ne. Ne njohuritë dhe botëkuptimet tona të kufizuara i përcaktojmë brenda kufijve të gjuhës që e njohim dhe përdorim. Po, ku, konkretisht, mbështetet skeleti i një gjuhe? Ai mbështetet në përbërësit gramatikorë, strukturën dhe shprehjen; konceptet gjuhësore, përjetimet fizike dhe emocionale, idiomat, maksimat, aksiomat, truizmat, frazeologjizmat, përshkrimi i fjalëve dhe njerëzve; faktori kohë (e shkuara, e tashmja, e ardhmja etj.); gjuha e trupit (gjesti, mimika, largësia hapësimore e komunikimit); pasthirmat, theksi, intonacioni, melodia; kuptimi (konotacioni + denotacioni); kultura, religjioni etj. Nëse të gjitha këto elemente dhe faktorë vështrohen në aspekt psikolinguistik, do të shohim se ndryshe bashkëveprojnë te folësit njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh. Në këtë kumtesë do t'i trajtojmë pikërisht këto çështje. Shpresojmë që në të ardhmen kjo fushë të lëvrohet më shumë edhe nga albanologët e tjerë me studime edhe më të thelluara.

**Fjalët çelës:** psikologji, kulturë, botëkuptim, folës (njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh).

Gjuha shqipe, si gjuhë e lashtë në këto troje, ka zgjuar interes të veçantë te shumë gjuhëtarë dhe deri më sot është studiuar në shumë aspekte dhe në disa fusha më shumë e në disa më pak. Në aspekt psikolinguistik është studiuar fare pak, për të mos thënë, aspak, sepse kjo disiplinë është e re jo vetëm për ne.

*Ne njohuritë dhe botëkuptimet tona të kufizuara i përcaktojmë brenda kufijve të gjuhës që e njohim dhe përdorim. Vokabulari gjuhësor mund të këmbehet me një gjuhë tjetër, edhe pse jo tërësisht, sido qoftë, dy folës që flasin dy gjuhë të ndryshme, mund të*

*komunikojnë mes veti përmes interpretimit. Arsyeja e botëkuptimit dhe ndërgjegjes sonë në një gjuhë të caktuar është e kufizuar, jo sepse nuk e njohim plotësisht vokabularin e asaj gjuhe, por për shkak të faktit se vokabulari i cilësdo gjuhë ndryshohet dhe modifikohet me kalimin e kohës. Kur korniza apo struktura e një gjuhe plekset me amalgamin e saj kulturor, bëhet unike. Prandaj njohuritë dhe botëkuptimet tona kur ne ballafaqohemi me botën, gjegjësisht me “tjetrin”, mbështeten në gjuhën apo në gjuhët që i njohim dhe përdorim. Bota ekziston vetëm e tillë siç ekziston në gjuhë, jashtë gjuhës bota sikur zhduket. Po, ku, konkretisht, mbështetet skeleti i një gjuhe? Ai mbështetet në përbërësit gramatikorë, strukturën dhe shprehjen; konceptet gjuhësore, përjetimet fizike dhe emocionale, idiomat, frazeologjizmat, aksiomat (thëniet e vetëkuptueshme), truizmat (të vërtetat e rëndomta), përshkrimi i fjalëve dhe njerëzve; faktori kohë (e shkuara, e tashmja, e ardhmja etj.); gjuha e trupit (gjesti, mimika, largësia hapësimore e komunikimit); pasthirrat, theksi, intonacioni, melodia; kuptimi (konotacioni + denotacioni); kultura, religjioni etj.*

Jetojmë në një “çast hibrid”, në një kulturë heterogjene bashkëkohore. Dallimi qëndron te secili prej nesh, kjo ndryshueshmëri e përbën tërësinë. Për gjuhën dhe për qenësoren nuk ekziston kod, strukturë, gjuha është dallimi vet, e cila funksionon vetëm përmes lojës shekullore që gjallëron me kohën. Gjuhën të cilën e dëgjojmë shpesh apo vazhdimisht, edhe nëse nuk është gjuha jonë amtare, ne nuk e llogarisim si të huaj. (p.sh. për shqiptarët maqedonishtja, serbishtja apo për emigrantët gjuhën e vendit ku jetojnë). Folësi shumëgjuhësh (multilinguisti) në të shumtën e rasteve është në gjendje t'i njohë dhe kuptojë strukturat e gjuhëve, e njëkohësisht akoma më mirë e zhvillon vetëdijen për gjuhën amtare. Dhe nga këndvështrimi

psikologjik, ky person ndryshe e sheh dhe kupton botën përreth tij.

Gjuha në të cilën mendojmë (me vetëdije apo nënvetëdije) i parapërcakton kufizimet dhe veprimet tona. Nëse një person njih gjuhë të dytë, por jo shumë mirë, kur do të gjendet në të ashtuquajturën “pikë e fundit e njohurive”, ai me nënvetëdije do të bazohet në gjuhën amtare (të parë). Ndërkaq, nëse i njëjti di edhe gjuhë të tretë, katërt etj., por jo aq mirë, shumë lehtë gjendet dhe mund të shprehet duke i kombinuar format strukturore të gjuhëve që njih. Kryesisht gabimet që më shpesh hasen tek folësit dy dhe shumë gjuhësh janë radhitja e fjalëve në fjali, vendosja e gabuar e theksit dhe përdorimi i gabuar i formave përkatëse apo shprehjeve, të cilat mungojnë apo janë ndryshe në gjuhën e parë dhe të gjitha këto sepse në vetëdijen tonë mendojmë në gjuhën e parë dhe kur flasim gjuhë të dytë, të tretë apo gjuhë tjetër, ne s’bëjmë tjetër, përpos se përkthejmë mendimin tonë në gjuhë tjetër. Kështu zakonisht lindin kalket.

Sa kultura e një shoqërie ndikon mbi strukturën e një gjuhe? Shumë. Do pyesim, po pse vallë? Sepse doket, zakonet, ligji politik-shoqëror, feja, folklori, mitologjia e shumë përbërës të tjerë të kulturës drejtpërdrejt ndikojnë në mënyrën e të menduarit, të kuptuarit, arsyes dhe veprimit të një personi. Shembull i përkryer për këtë është anglishtja e Britanisë së Madhe, Amerikës, Australisë, kolonive angleze, shteteve ku ka baza amerikane etj. pra, e njëjta gjuhë ka rrugëtuar në shtigje dhe forma të ndryshme varësisht nga kulturat dhe faktorët e tjerë jashtëgjuhësorë të folësve të lartpërmendur. Edhe shqipja e Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës dhe diasporës ka pësuar ndryshime të ngjashme. Kjo më së shumti vërehet në ndërtimin e shprehjeve frazeologjike, tek idiomat, truzimat, aksiomat, gjetet, mimikat etj. Ndërkaq, nëse këtë element e krahasojmë mes disa gjuhëve, konkretisht po e marrim anglishten, do vërejmë se: kultura dhe civilizimi anglez (amerikan), për shkak të aktualizimit të individualizimit dhe demokracisë, rrit vetëbesim dhe vetëvlerësim më të madh të unit, prandaj të gjitha fjalitë në vetën e parë fillojnë me përemrin “I” (unë) dhe gjithmonë shkruhet me shkronjë të madhe. Këtë dukuri në mënyra të ndryshme e kuptojnë një folës njëgjuhësh (që e njih dhe që s’e njih anglishten), një folës dygjuhësh, tregjuhësh etj. Kurse në anën tjetër spikatet dhe respekti ndaj tjetrit, i cili vërehet nga vendndodhja e përemrave në fjali, p.sh.: **You and me** dhe jo: **I and you** apo: **Me and you** (unë dhe ti), siç ndodh te gjuhët ballkanike.

*Nga ky këndvështrim mund të analizohet edhe reagimi nga një skenë e rëndomtë apo bisedë në një emision*

*televiziv (p.sh. nëse një djalë e pështyn një vajzë. Apo kur një vajzë vetëvritet me rit. Apo kur dy burra të pjekur e puthin njëri-tjetrin në faqe etj.), ndryshe do ta përjetonte një monolingvist shqiptar, maqedonas, amerikan, kinez, eskimez, japonez, afrikan etj. (do të qeshë, do të bezdiset, do të turpërohet, do të gërditet etj) varësisht nga kultura dhe civilizimi i tij. Por, ndryshe nëse njih edhe ndonjë gjuhë dhe kulturë tjetër. Kategoritë e ndryshme të frazeologjive përfaqësojnë vështirësi gjatë përkthimit. Ato asnjëherë nuk mund të përkthehen plotësisht dhe të kuptohen në po të njëjtën mënyrë në një mjedis tjetër. p.sh.: **S’e çaj kokën fare (I don’t crack my head, не ja цапам главата, kesmem(yarmam) başımı)**, përpos në shqip, nuk kanë kuptim apo vlerë të njëjtë kuptimore në gjuhët tjera.*

Shprehja: **s’ka mal pa ujk**, vështruar në aspekt sintaksor ka ndërtim të një fjalie të rëndomtë, por nëse përkthehet në ndonjë gjuhë tjetër fjalë për fjalë, nuk do ta ketë kuptimin e njëjtë sikurse në shqip. E njëjta gjë ndodh edhe me shprehjet përshëndetëse dhe për mirësjellje, të cilat shumë ngushtë janë të lidhura me kulturën, traditën, mënyrën e të jetuarit dhe rregullimin shoqëror të një populli që e flet atë gjuhë, p.sh. **Ju bëftë mirë! Tungjatjeta! Falemnderit! Mender qofsh!** Nëse folësi dygjuhësh nuk i njih plotësisht të dyja gjuhët dhe kultura, domosdo duhet ta njohë së paku mënyrën e të menduarit të gjuhës së dytë që të mund ta kuptojë dhe më lehtë t’i përkthejë shprehjet e këtilla, të cilat janë të shumta. Një element tjetër gjuhësor që mund të analizohet në aspekt psikolinguistik është përcaktimi kohor, gjegjësisht konceptimi i faktorit kohë të folësit njëgjuhësh, dy apo më shumë gjuhësh dhe në kultura të ndryshme. p.sh. nëse i thua një gjermani, një ballkanasi, japonezi, banori të Saharës etj. që **do të vij për 5 minuta**, secili prej këtyre ndryshe do ta kuptojë këtë informatë apo kohëzgjatje. Apo nëse të njëjtëve u themi: **Ajde urdhëro për një çaj (apo kafe)**, gjithashtu nuk do të nënkuptohet njëjtë nga të gjithë. Gjermani dhe japonezi do ta pijnë kafën dhe do të ikin menjëherë, por ballkanasi do të qëndrojë në ndeje 2-3 orëshe.

Në anën tjetër nëse krahasojmë fjalitë: **Aj se po shkoj nesër = aj se kam me shku: nesër = aj se do (të) shkoj nesër** këto forma nga të folme krahinore të ndryshme shprehin kohën reale të njëjtë, por të paraqitura me kohë foljore të ndryshme. Përdorimi i këti lloji dysorish, jo gjithmonë ndërlidhet me atë që është thjesht psikologjike, ndonjëherë di të jetë pjesë e kontekstit apo stilit. Paralelizma të këtilla hasen shumë në gjuhën tonë, megjithatë në këtë kumtesë nuk do t’i trajtojmë më gjërisht.

Aksiomat si thënie të vetëkuptueshme, lidhen gushtë me rrethin (faktorët sociologjikë) dhe botëkuptimin (faktorët psikologjikë) të folësit dhe bashkëbiseduesit. P.sh. nëse një gruaje nga rrethi i Strugës i themi: **Nuk e paske burrin në shtëpi**, ajo do të na përgjigjet: **Po sot është e sht:un**, që vetëkuptohet se burri i saj është në qytet, sepse është ditë pazari dhe zakonisht ai, si edhe shumë njerëz nga të gjitha venbanimet e rrethit të Strugës, tradicionalisht të shtunave, përpos tregëtimit, takohet me miq, të njohur ose më pak të njohur, bile e zgjeron rrethin e të njohurve. Në këtë kontekst mund të japim edhe një shembull tjetër, gjegjësisht nëse parashtrohet pyetja: **Ku mund ta gjej filan fistekun?** (për dikënd që dëshirojmë ta takojmë, por nuk e dimë adresën e tij), me siguri do ta marrim përgjigjen: **Dil të shtunën në Strugë**, sepse edhe nëse nuk arrijmë që ta takojmë pikërisht atë që ne dëshirojmë, patjetër që do të takojmë dikë që e njeh mirë atë që ne kërkojmë dhe do mund të na dërgojë deri tek ai.

Në analogji me këtë mund të përmenden aksioma nga ndryshueshmëria (diferencimi) kulturor, si p.sh.: nëse një nxënësi të Francës i thuhet që **“Sot është e shtunë”**, ai do të gëzohet, sepse vetëkuptohet se ka një pasdite të lirë dhe nuk është në mësim si ditëve tjera, kurse po të njëjtën gjë nëse ia themi ndonjë nxënësi nga Maqedonia apo Shqipëria, kjo informatë nuk vetëkupton asgjë të veçantë, veçse një ditë pune të zakonshme sikurse pesë të tjerat. Si enigma psikolinguistike hapësirë të madhe në korpusin gjuhësor zënë ato shprehje frazeologjike që kanë lindur nga ngjarje të vërteta historike apo janë të lidhura ngushtë me legjenda kombëtare ose regjionale. P.sh. që të nënkuptohet domethënia e shprehjes: **U zumë për mustaqet e Çelos** apo shprehja: **Ah edhe ti, flet si e ëma e Zeqos (në majë të thanës)** apo truiizmat lokale: **Mos bëj si Çezibani, U bëre si Melaimi** etj.,

#### Bibliografia

FERGUSON, Ch., *Language Structure and Language Use*, Stanford, Kalifornia, 1971.  
FISHMAN, J. *Who speaks, What language, to whom and when*, La Linguistique, 2, 1965.

bashkëbiseduesi duhet ta dijë tërë historinë e njësisë frazeologjike prej ku e ka prejardhjen apo të paktën ta ketë dëgjuar disa herë këtë shprehje dhe me çfarë vlere kuptimore apo qëllimi bisedor përdoret, që të mundet ta kuptojë këtë, përndryshe kjo shprehje për të nuk do të ketë kurrfarë kuptimi.

Komunikimi i trupit dhe distanca hapësinore gjatë komunikimit shumë ndryshe konceptohet te persona nga shtresa të ndryshme shoqërore, nga niveli i arsimimit, vendbanimi, kombi, përkatësia fetare, gjinia etj. Konkretisht, për shqiptarët, sidomos të zonave rurale dhe me nivel arsimimi më të ulët, më me respekt është që t'i qëndrojnë më afër bashkëbiseduesit, sepse me atë shpreh jo vetëm respektin ndaj bashkëbiseduesit, por edhe afri, besim e siguri. Ky botëkuptim ndryshon te shqiptarët me nivel arsimimi apo shtresë sociale më të lartë. D.m.th. largësia hapësinore me bashkëbiseduesin shkon duke u rritur. Ndërkaq, të qënurit shumë afër bashkëbiseduesit, konceptohet krejtësisht ndryshe (negativisht) te gjeneratat e reja të emigrantëve shqiptarë apo në kulturat e civilizimit Perëndimor.

Nuk gabojmë nëse përmbyllim se nga çdo këndvështrim folësit shumëgjuhësh (multilinguistët, poliglotët) janë njohësit më të përkryer të gjuhës amtare dhe në krahasim me folësit dygjuhësh (bilinguistët), këta të parët gjuhën e dytë e shqiptojnë dhe theksojnë më mirë, bëjnë më pak gabime strukturore gjatë të folurit në gjuhën 2 dhe 3, në aspekt psikologjik janë më racionalë, shpejtë përshtaten dhe janë më të gjindshëm në situata të ndryshme.

U përpoqëm që në pika të shkurtra dhe në mënyrë të përciptë t'i prekim disa çështje që duhet trajtuar edhe më thellësisht. Dhe shpresojmë që në të ardhmen kjo fushë të lëvrohet më shumë.

ISLAMAJ, Sh., *Kultura e gjuhës dhe përdorimi estetik i saj*, Tiranë, 2002.

RADOVANOVIĆ, M., *Sociolingvistika*, Novi Sad, 1986.  
SHKURTAJ, Gj., *Sociolingvistika*, Tiranë, 1999.